Shkulja dhe mbjellja e drurëve të rritur në praktikën e ndërtimit të gjelbër bëhet më me vështirësi se sa për fidanët e vegjël, prandaj ky proces kërkon punonjës dhe punëtorë me nivel të lartë kualifikimi, mjete të posaçme të shkuljes, ambalazhimit, ngarkimit në makineri, transportit deri në objekt, shkarkimin dhe deri mbjelljen e tyre duke zbatuar rigorozisht teknikën e domosdoshme.

SHKULJA E DRURËVE

Para fillimit të shkuljes, duhet të caktohet se sa do të jetë diametri i bukës së dheut. Ky praktikisht përcaktohet duke marrë 8-10 herë diametrin e trungut të fidanit në lartësi 1.30 m (afërsisht në lartësinë e gjoksit të njeriut) nga toka. Po kështu thellësia e bukës së dheut përcaktohet nga madhësia dhe shtrirja e

sistemit rrënjor të fidanit. Në përgjithësi kjo thellësi është rreth 80-100 cm. Forma e bukës së dheut duhet të jetë kubike, piramidë e prerë me bazë katrore ose cilindrike. Në qendër duhet të jetë trugu i pemës.

Gjatë shkulljes së fidanëve të rritur duhet të ruhet dhe të mos dëmtohet sistemi rrënjor bazë (kryesor), por të priten vetëm rrënjë të veçanta të trasha, të thyera gjatë prerjes ose të kalbura. Prerja e këtyre rrënjëve duhet të bëhet e rrafshët dhe përpjendikulare për të mos shkaktuar çarje të rrënjëve, pasi kjo mund të sjellë kalbëzimin e tyre dhe mbas një kohe edhe tharjen e vetë fidanit. Pasi të jetë caktuar madhësia dhe forma e bukës së dheut, Pasi të ketë përfunduar mbështjellja e bukës së dheut bukës së dheut, fidani është gati për transportim në vendin e ri. Drurëve të rritur, një vit më parë, duhet t'u bëhet prerja e sistemit rrënjor duke pasur parasysh madhësinë e bukës së dheut me të cilën do të shkullen.

TRANSPORTIMI I DRURËVE

Drurët normalisht duhet të furnizohen në kontenjerë, vazo, vaska prej druri ose plastike; në varësi të kërkesave teknike dhe specifikimeve të formuluar nga ana e grupit të specifikimeve teknike, ndërkohë që vetëm drurët gjetërenës mund të dorëzohen rrënjëzbathur, me kusht që këta të fundit të jenë të rinj dhe me përmasa të kufizuara. Kontejnerët dhe vazot (vazot, vaskat prej druri ose plastike, etj.) të jenë proporcionale me përmasat e bimës.

Për drurët e furnizuar me kontenjerë dhe/apo vazo, ato duhet të jenë të mbjella në formë kompakte, materiali organik (buk dheu) duhet të jetë i ngjitur mirë me rrënjët, pa çarje të dukshme në strukturë në mënyrë të tillë që të mos përbëjë një rrezik të mundshëm asfiksimit.

Drurët e vendosur në kontejnerë gjatë procesit të rritjes duhet që të jenë ri-mbjellë disa herë (pra duhet të kenë ndërruar vazot në të cilën janë mbjellë disa herë përgjatë procesit të rritjes), në mënyrë që mos paraqesin një aparat rrënjësor të zhvilluar në mënyrë të tepruar në skajet e kontejnerit apo vazos mbajtëse (shiko figurën nr.1; figurën nr.2; figurën nr.3 dhe figurën nr.4).

Kontejnerët apo vazot duhet të jenë cilësorë me një element mbështjellës të posaçëm të bio-degradueshëm (jute, kashtë, material veshës pambuku, rrjeta hekuri jo të galvanizuar, etj.), të përforcuara në rastin kur bimët i kalojnë 5 metra lartësi, ose me rrjetë teli të degradueshme ose bërë me film poroz plastik ose të përbërë nga materiale të tjera ekuivalente.

Në rastin e ambalazhimit prej dërrase veprohet kështu: dërrasat me gjatësi sa madhësia e bukës së dheut dhe me trashësi 5cm, mbërthehen paraprakisht jashtë gropës,veças, për çdo faqe të formës së bukës së dheut. Pastaj këto montohen në vend duke mbërthyer në pjesën e sipërme dërrasa më të trasha në formë kryqi 10-15 cm, larg trugut të fidanit me qëllim që gjatë transportit të mënjanohej zhveshja e lëkurës së

trungut të tij. Mbas kësaj arka e formuar përcaktohet duke e mbërthyer edhe nga poshtë me dërrasa të të njëjtës përmasë. Kjo kryhet më me lehtësi kur fidanin me gjithë arkë e kthejmë pjerrtësi. Pasi të ketë përfunduar inkasimi I bukës së dheut, fidani është gati për transportim në vendin e ri. Kur inkasimi bëhet me kashuna metalikë, ata parapërgatiten në dy pjesë, të cilat duke u bashkuar, formojnë një trung koni. Mbas fidani të jetë shkukur, bukës së dheut i jepet forma e kashunit metalik dhe madhësia pak më e vogël se vetë kashuni me qëllim që ai të mbyllet plotësisht. Dy pjesët e kashunit shtrëngohen mirë derisa të bashkohen kllapat metalike dhe pastaj lidhen me tel ose bulona. Ne këtë gjendje fidani është gati për

t'u transportuar. Drurëve të rritur, një vit më parë, duhet t'u bëhet prerja e sistemit rrënjor duke pasë parasysh Rregullimi i Kopshteve 104 madhësinë e bukës së dheut me të cilën do të shkulen.

Figura nr.1




Figura nr.2




Figura nr.1 dhe Figura nr.2 demonstronë se si nuk duhet të jetë rrënja e pemës e vendosur në vazo apo

Figura nr.3




Figura nr.3 tregon një sistem rrënjësor të shëndetshëm.

Figura nr.4



Figura nr.4 tregon dru (pemë) e cila do të zhvendoset në një kontejner tjetër më të madh, dhe gjatë këtij procesi rrënjët e holla të cilat kanë filluar të

Drurët e rritur të inkasuar, detyrimisht duhet të transportohen me automjet. Duke qenë se pasha e bukës së dheut dhe e fidanit është shumë e madhe ngarkimi i fidanit në automjet bëhet me vinç. Me qëllim që gjatë transportit, të mos dëmtohen degët e fidanit, ato duhet të lidhen me litar në formë spirale.

Në automjet, fidani vendoset i shtrirë në mënyrë të tillë që e dheut të shtrihet në pjesën e karrocerisë së automjetit. Duhet theksuar se aty ku mbështeten degët e fidanit, duhet të vendosen material të buta ambalazhimi, me qëllim që të mos shkaktohen dëmtime. Që fidani gjatë ngarkimit e shkarkimit të rrotullohet në çdo pozicion, ai duhet të lidhet me litar të gjatë dhe të ngrihet me vinç. Mbas ngarkimit të fidanit, bashkë me automjetin nisët për në vendin e mbjelljes edhe vinçi. Kur fidani transportohet në largësi të largëta e në kohë me diell, pjesa e inkasuar e bukës së dheut duhet mbuluar me rrogozë, të cilët duhet të mbahen të lagura gjatë gjithë kohës së transportimit. Nuk këshillohet asnjëherë që fidanë të tilla të shkulen, transportohen e mbillen kur temperatura zbret në (-10 grade). Për një mbjellje të suksesshme dhe ecuri normale vegjetative është kusht i domosdoshëm, që fidanit para se të shkulet e të transportohet, duhet t'i shënohet në trung me bojë vaji drejtimi veri-jug që ka pasë në vendin ekzistues, sepse edhe në vendin e ri të mbledhjes fidani duhet të vendoset po në atë drejtim. Mosrespektimi i këtij kushti shpesh shkakton zhvillim jonormal të kurorës së fidanit.

MBJELLJA E DRURËVE

Drurët duhet të plotësojnë kërkesat e pozicionimit në vendin e posaçëm dhe të kenë referenca të caktuara sipas secifikimeve teknike lidhur me specien, përmasat, varietetin dhe moshën në kohën e mbjelljes së tyre. Drurët duhet të jenë kultivuar posaçërisht për llojin e përdorimit të parashikuar (p.sh. të kultivuara në

grup, pra ekzemplarë të kultivuar pranë njëri-tjetrit dhe ekzemplarë të kultivuar veçmas). Në veçanti degët e kërcellit dhe përbërësit kryesor të rrënjëve dhe trungut të jenë të lirë nga deformime, si p.sh kurora të deformuara, dëmtime të çdo origjine dhe lloji, dëmtime ose shenja të mëdha që vijnë nga goditjet, dëmtime nga fenomene natyrore si breshëri, dëmtime të lëvores (mungesë e lëvores), organizma të llojit kërudhë, djegie nga dielli, si dhe shkaqe mekanike në përgjithësi. Kurora përveç se në rastet kur kërkohet ndryshe në specifikime teknike, duhet të jetë e degëzuar mirë, uniforme dhe e ekuilibruar, ndërkohë që simetria duhet të jetë e rregullt dhe shpërndarja e degëve kryesore dhe dytësore të trungut e rregullt. Sistemi rrënjor duhet të jetë i degëzuar mirë, i pasur me degë të vogla dhe rrënjë kapilare të freskëta dhe të shëndetshme ku të mungojnë dëmtime të tilla si p.sh prerjet me diametër më të madh se një centimetër.

Koha e përshtatshme për mbjellje. Drurët dhe shkurret zakonisht mbillen vetëm gjatë periudhës së pushimit të vegjetacionit, pikërisht atëherë kur proceset jetësore të tyre zvogëlohen në minimum.

Përpara se të vazhdohet me proceset e punës në tokë (vendosjen / mbjelljen e drurëve), duhet të një plan i mire pune referuar referuar udhëzimeve të specialistëve të fushës, me procese pune si prerja e bimësisë spontane aty ku nuk parashikohet ruajtja e kësaj lloji bimesie, pastrimin dhe eliminimin e specieve të konsideruara dëmtuese bazuar në mendimin ekspert të grupit ndjekës të procesit të vendosjes së drurëve jo në përputhje me nevojat e mbjelljes, gjithashtu aty ku shikohet e domosdoshme duhet të kryhet çrrënjësia e cungjeve dhe heqja sipërfaqësore e gurëve.


Gjatë punimeve të gërmimit do të duhet të hiqen të gjithë gurët e mëdhenj të cilët përbëjnë një barrier pengese, gjithashtu guriçkat, si dhe çdo pengesë tjetër nëntokësore që do të mund të pengonte kryerjen korrekte të vendosjes (mbjelljes) së drurëve. Referuar këtij procesi aty ku shikohet e përshtatshme nga ekspertët e fushës në grupin e ndjekjes së kontratës referuar elementëve të tillë si (gurë apo formime të tjera natyrore) të cilat për efekt estetik apo natyror janë pjesë përbërëse e ambientit përreth apo do të mund të kenë një përdorim efektiv në momentin e punimeve apo sipas gjykimit të ekspertëve të fushës në një moment të dytë, këto element mund edhe të mos zhvendosen. Gjatë punimeve, në rast të përballjes me pengesa natyrore me përmasa domethënëse që paraqesin vështirësi, ose objekte nëntokësore të çfarëdo natyre që janë të panjohura se ekzistojnë (p.sh. kabllot, kanalizimet, tuba, gjetje arkeologjike, etj.), punëtorët duhet të njoftojnë ekspertët e fushës në grupin e ndjekjes së kontratës.

Gropa në të cilën mbillen drurët e rritur duhet të hapet disa ditë më përpara se të kryhet mbjellja. Në varësi të përmasave të bimësisë së kërkuar hapet dhe gropa, konkretisht për drurë (pemë) me përmasa të diametrit deri 6 cm dhe bukë dheu 60 cm, gropa hapet me përmasa 80x80x80cm. Fidani (druri_pema) vendoset përpjendikularisht, 30-40 cm mbi dheun e hedhur paraprakisht në gropë, i cili duhet të jetë dhe' i mirë vegjetal dhe pa gurë apo inerte, druri mbahet drejt nga një punëtor dhe nga dy punëtorët e tjerë

fillohet të mbushet nga të gjitha anët me dhe' i cili vazhdimisht ngjishet me këmbë, si në figurën e mëposhtëme (figura nr.5). Ky proces pune duhet të kryhet nëpërmjet përdorimit të mjeteve mekanike dhe / apo mjeteve specifike në varësi të parashikimit në specifikime teknike dhe / apo terma të referencës.

Mënyra e hapjes së gropës dhe mbjellja e fidanit (drurit_pemës) figura nr.5


Figura nr.5



Gjithashtu puna do të duhet të kryhet në periudha të përshtatshme, duke patur parasysh nivelin optimal të lagështisë së tokës ku do të mbillen drurët, duke shmangur kështu dëmtimin e mundshëm strukturor të rrënjëve të drurëve. Gjithashtu për të shmangur mbivdendosjen e dheut (vendosja e një shtrese dheu të fortë më në sipërfaqe dhe një dheu më të butë më në thellësi) faktor i cili do të sillte dëmtimin e mundshëm të rrënjëve të trungut.

Një shtresë me pleh organik, të tilla si gjethet e rëna të pemëve në vjeshtë, lëvorja e copëtuar e drurëve ose copëza të imta druri (në formë tallashi), ndihmojnë në mbrojtjen e rrënjëve të pemëve nga temperaturat ekstreme dhe gjithashtu bëjnë të mundur ruajtjen e lagështisë së tokës. Plehu organik gjatë mbjelljes së drurëve gjithashtu ndihmon në parandalimin e rritjes së barërave të këqinj dhe rrjedhimisht në përmirsimin e thithjes së elementëve të ushqyeshëm organik. Zona e mbuluar me pleh organik e bën më të lehtë funksionimin kositës të barërave të këqinj pa përbërë rrezikshmëri për trungun dhe gjithashtu parandalon ngjeshjen e tokës (dheut). Aplikimi i plehut organik duhet të kryhet në një thellësi prej 7 deri në 10 cm (me një sasi më të pakët përreth trungut – shiko figurën Nr.6).

Figura nr.6



Pozicionimi i drurëve nëpërmjet dërrasave mbajtëse: Metoda e pozicionimit të drurëve (të qëndruarit vertikalisht në ekuilibër) varet nga aftësia e drurit (pemës) të qëndroj vertikalisht vet pa ndihmën e pozicionimit të një dërrase mbështetëse, si dhe karakteristikave të zonës ku do mbillen drurët. Kjo mënyrë pozicionimi ndihmon drurin që të qëndrojë i drejtë në mënyrë vertikale, ndihmon rrënjët të zhvillohen si duhet, dhe gjithashtu ndihmon trungun nga dëmtime të mundshme si pasojë e përdorimit të mjeteve të ndryshme të punës gjatë mbjelljes. Për ta ruajtur nga përkulja dhe shtrembërimet që mund të shkaktohen nga era, fidani (druri_pema) atje ku fillon kurora lidhet nga të tëra anët me tel i cili fiksohet në kunja të futur në tokë. Trupi i fidanit (druri_pema) në vendin ku lidhet me tel duhet të mbështillet me material të butë ambalazhimi. Kjo lidhje i hiqet vetëm pas 2-3 vjetëve.

(shiko figurat nr.7 dhe nr.8).

Figura nr. 7






Figura nr.8



Shpesh herë prerja e parakohshme e degëve tek drurët_pemët e reja ngadalson rritjen e cirkoferencës së drurit. Pemët e reja të cilat janë rritur me degët e poshtëme të pa prera (shiko figurën nr.9) kanë një zhvillim më të shpejtë dhe një cirkoferencë më të madhe të trungut, se sa ato të cilave ju janë prerë degët e poshtëme më herët se duhet.

Figura nr.9



Në përfundim të procesit duhet të ujitet me ujë të bollshëm. Kur gropa është mbushur plotësisht me dhe, rreth e përqark saj formohet një unazë dhe e cila do të shërbejë më vonë për mbajtjen e ujit gjatë ujitjes dhe reshjeve të shiut. Këtë ujë fidani (druri_pema) do ta thithë gradualisht për një kohë më të gjatë.

SHËRBIMET PAS MBJELLJES

Është e domosdoshme që vitin e parë pas mbjelljes, bimësia dekorative drurë dhe shkurret duhet të ujiten rregullisht çdo tre ditë. Toka poshtë kurorës duhet të shkriftohet e prashitet, kurse gjatë verës kur temperatura është e lartë është e nevojshme që t'u bëhet edhe vaditja e spërkatja me ujë e kurorës.

Specifikime Teknike me Foto Ilustruese:

Sqarim: Fotot janë kanë vetëm qëllime ilustruese.



1. *Tilia platyphyllos*, (me perimetër 14_16 cm në 1.3 m nga toka)
 2. *Tilia platyphyllos*, (me perimetër 20_25 cm, 1.3 m nga toka)
 3. *Tilia platyphyllos*, (me perimetër 30_35 cm, 1.3 m nga toka)
-



4. *Cinnamomum camphora* (L.) Nees & Eberm. (me perimetër 30_35 cm , 1.3 m nga toka).
-



5. *Libocedrus austrocaledonica*, (me perimetër 14_16 cm , 1.3 m nga toka)



6. *Pinus pinea*, (me perimetër 45_50 cm , 1.3 m nga toka. Në vazo.



7. *Aesculus hippocastanum*, (me perimetër 14_16 cm , 1.3 m nga toka)



8. *Cedrus Deodara*, (me perimetër 60_65 cm , 1.3 m nga toka)



9. Ekualiptus Globulus, (me perimetër 35_40 cm , 1.3 m nga toka)



10. Cupressus sempervirens, h = 4-5 m



- 11. Platanus orientalis, (me perimetër 60_80 cm , 1.3 m nga toka)**
 - 12. Platanus orientalis, (me perimetër 18_20 cm , 1.3 m nga toka)**
 - 13. Platanus orientalis, (me perimetër 14_16 cm , 1.3 m nga toka)**
-



14. *Magnolia grandiflora*, (me perimetër 20_25 cm , 1.3 m nga toka). Në vazo.

15. *Magnolia grandiflora*, (me perimetër 14-16 cm , 1.3 m nga toka)



16. Ginkgo biloba, (me perimetër 14-16 cm , 1.3 m nga toka)



17. Prunus Pissardi, (me perimetër 16_18 cm , 1.3 m nga toka)



18. Quercus coccinea, (me perimetër 20_25 cm , 1.3 m nga toka)



19. *Acer pseudoplatanus*, (me perimetër 18_20 cm , 1.3 m nga toka)



20. Quercus Ilex, (me perimetër 14_16 cm , 1.3 m nga toka)



21. Acer Platanoides, (me perimetër 16_18 cm , 1.3 m nga toka)



22. Cercis siliquastrum, (me perimetër 14_16 cm , 1.3 m nga toka)



23. Liquidambar styraciflua, (me perimetër 14_16 cm , 1.3 m nga toka)



24. Acer negundo, (me perimetër 20_25 cm , 1.3 m nga toka)



25. *Acer japonicum*, (me perimetër 14_16 cm , 1.3 m nga toka)

26. *Acer japonicum*, (me perimetër 18_20 cm , 1.3 m nga toka)



27. Cupressocyparis leylandii, h = 2.5-3 m



28. Carpinus betulus, (me perimetër 16_18 cm , 1.3 m nga toka)



29. *Cupressus arizonica* Variegata, h = 2.5 - 3 m



30. *Celtis australis*, (me perimetër 14_16 cm , 1.3 m nga toka)



31. *Acacia Dealbata*, (me perimetër 14_16 cm , 1.3 m nga toka)



32. *Fraxinus angustifolia* Vahl, (me perimetërr 14_18 cm , 1.3 m nga toka)



33. *Olea Europaea*, (me perimetër 100-120 cm , 1.3 m nga toka). Në vazo.



34. *Catalpa bignonioides*, (me perimetër 18_20 cm , 1.3 m nga toka)



35. Laurus Nobilis, me perimetër 14_16 cm , 1.3 m nga toka



36. Ulmus (me perimetër 14_16 cm , 1.3 m nga toka)



37. Sorbus aucuparia, (me perimetër 14_16 cm , 1.3 m nga toka)



38. Acer platanoides Crimson King, (me perimetër 18_20 cm , 1.3 m nga toka. Nëvazo)



39. Albizia julibrissin, (me perimetër 18_20 cm , 1.3 m nga toka). Në Vazo



40. Alnus glutinosa, (me perimetër 16_18 cm , 1.3 m nga toka). Në Vazo.



41. Callistemon laevis, (me perimetër 16_18 cm , 1.3 m nga toka). Në vazo.



42. *Cupressus sempervirens stricta*, h = 800-850 cm. Në vazo



43. *Fraxinus angustifolia* raywood (me perimetër 18_20 cm , 1.3 m nga toka). Në vazo.



44. *Gleditsia triacanthos*, (me perimetër 20-25 cm , 1.3 m nga toka). Në vazo



45. Magnolia Grandiflora pyramidal, h= 450-500 cm. Në vazo



46. Malus everest, (me perimetër 18_20 cm , 1.3 m nga toka). Në vazo.



47. *Melia azedarach*, (me perimetër 25_30 cm në 1.3 m nga toka). Në vazo.



48. *Parrotia persica*, (me perimetër 16_18 cm , 1.3 m nga toka). Në vazo.



49. Morus alba, (me perimetër 20_25 cm , 1.3 m nga toka). Në vazo.



50. Pinus Pinea (me perimetër 40_45 cm , 1.3 m nga toka) h = 500-600 cm. Në vazo.



51. *Prunus serulata* Kanzan, (me perimetër 20_25 cm , 1.3 m nga toka). Në vazo.



52. *Pyrus calleryana* chanticleer, (me perimetër 25_30 cm , 1.3 m nga toka). Në vazo.



53. *Quercus rubra*, (me perimetër 18_20 cm , 1.3 m nga toka). Në vazo.



54. *Robinia pseudoacacia casque rouge*, (me perimetër 20_25 cm , 1.3 m nga toka). Në vazo.



55. *Sophora japonica*, (me perimetër 18_20 cm , 1.3 m nga toka). Në vazo.



56. *Sorbus aucuparia*, (me perimetër 18_20 cm , 1.3 m nga toka). Në vazo.



57. *Stipa tenuissima*, h = 20-30 cm. Në vazo.



58. *Spiraea japonica* h = 60-80 cm. Në vazo.



59. *Thymus Vulgaris* h = 20-40 cm. Në vazo.



60. *Tulbaghia violacea* h = 20-40 cm. Në vazo.



61. Weigela bristol ruby h = 40-60 cm. Në vazo.



62. Salvia microphylla royal bumble, h = 30-50 cm. Në vazo



63. Hedera gloire de marengo h = 150-175 cm Në vazo



64. Ilex meserveae h =100 - 125 cm. Në vazo.



65. *Loropetalum chinensis* h = 60-80 cm. Në vazo.



66. *Dracena indivisa*, h = 80 - 100 cm. Në vazo.



67. Deutzia Gracilis, h = 30 - 35 cm. Në vazò.



68. Escallonia ivelyi, h = 30 - 50 cm. Në vazo.



69. Festuca Glauca , h = 20 - 40 cm. Në vazo.



70. Gaura lindheimeri (Oenothera lindheimeri) h = 40 - 60 cm. Në vazo.



71. Banana, h = 4 m. Në vazo.



72. Yucca, h = 2 m. Në vazo.



73. Palma humelix, h = 6 - 8 m



74. Thuja emerald, h = 1.5-2m



75. Buxus, h = 60 cm



76. Picea abies, h = 1.8-2m



77. *Nerium oleander* h = 60-80 cm



78. *Prunus laurocerasus*



79. *Laurus nobilis*, h = 2.5 m



80. *Nandina domestica*, h = 50



81. Nandina Nano, h = 30cm

- **Fotot janë vetëm për qëllime ilustruese.**

Per objektin ne reference.

Njësia e Hartimit të Dokumentave, në hartimin e dokumentacionit të kësaj procedure prokurimi, është mbështetur tek grupi i punës i ngritur për hartimin e nevojave, specifikimeve teknike, llogaritjen e fondit limit dhe kriterëve të vecanta teknike, të procedurës në reference.

Gjithashtu NJP është bazuar në nenin 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenin 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PASTRIMIT DHE GJELBËRIMIT, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e nevojave, specifikimeve teknike, fond limit dhe kriterëve të vecanta teknike.

Data e hapjes së ofertave planifikuar date 15.12.2022 Ora: 11:00

- www.app.gov.al
- *Gjuha(-ët) për hartimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje: Shqip dhe Anglisht*
- *Dokumentat pa pagesë.*

Njësia e prokurimit, bazuar në parashikimet ligjore dhe në objektin e prokurimit, vendosi kriteret e kualifikimit, të cilat gjejnë pasqyrim në Shtojcën 7 të DST –ve, kriteret, të cilat u konsideruan si të nevojshme për përmbushjen e kontratës, në përpjestim me përmasat dhe veçoritë e objektit që prokurohet dhe konkretisht, si më poshtë vijon:

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit/Kualifikimit, janë të pa ndryshueshme nga ato të miratuar nga APP në setin standart të dokumentave të tenderit.

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale; dh nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Kjo pikë përmbushet sipas pikës a) të Kritereve të Përgjithshme (*Vetëdeklarim, sipas shtojcës 8*)

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 (tri) viteve të fundit financiare (2019, 2020, 2021) të paraqitur në Autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky Autoritet si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse në dy balance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit).

Shënim: Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma "c" të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjin nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" dhe neni 41, pika "c", e ligjit nr.10091 datë 5.3.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar" i ndryshuar.

2.2.2 Kopje të deklaratimit të xhiros vjetore gjatë 3 (tri) viteve të fundit financiare (2019, 2020, 2021) lëshuar nga Autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Autoriteti Kontraktor i është referuar VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 43, pika 2, gërma a) dhe vlerën e xhiros minimale vjetore e ka përcaktuar brenda kufirit maksimal të lejuar nga ky nen.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohej, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të

Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklarave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike".

Për shkak të kufizimit në kohë dhe kushteve atmosferike dhe teknike për zbatimin e kontratës, ky kriter na lejon të vërtetojmë se OE zotëron kapacitetet financiare dhe ekonomike për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.2.3 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2021 ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar për vitin 2022 sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", (i ndryshuar). Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB. *(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotesimin e formularit të vetedeklarimit, këto dokumente do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, e LPP, si dhe të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Kjo kërkesë bazohet në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga cdo njësi e qeverisjes vendore për vitin 2022, ligjin nr.131/2015 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit" neni 3.1(a,b,c). Dokumentat e kërkuara me siper, do të paraqiten nga operatori ekonomik fitues para dhenies së kontratës ose nëse kerkohen sqarime nga A.K.

Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklarave për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2021 sipas kësteve pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për "Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t'iu nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e publikimit të njoftimit të kontratës, **në vlerën jo më të vogël se 40% e vlerës së fondit limit.** Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ose

faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në vlerë jo më të vogël se 40 % të fondit limit, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

2.3.2 Liçensa profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës:

Operatori Ekonomik duhet të disponojë Liçencë të shoqërisë e vlefshme për kategoritë e mëposhtme:

- N.P-1 A (Punime gjurmimi në tokë)
- N.P-7 A (Ujësjellja, gazsjellja, vajsjellja, vepra kullimi e vaditje)
- N.P-11 A (Ndërtim nënstacione, kabina të transformatorve, linja e TM dhe shprëndarja e energjisë)
- N.P-12 E (Punime të inxhinierisë së mjedisit)
- N.S-18 A (Punime topogjeodezike)

sipas modelit të lëshuar nga institucioni përgjegjës për dhënien e licensave profesionale sipas legjislacionit në fuqi.

Operatorët e huaj duhet të plotësojnë kërkesat e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës sipas përcaktimeve më sipër. Operatori ekonomik i huaj të ketë në licencën e tij ato kategori punimesh të kërkuara në dokumentat e tenderit, pavarësisht se kategoria e kërkuar, nuk korespondon me të njëjtin numër kategorie me kategorinë e punimeve në licencën e një operatori të huaj të lëshuar nga vendi i origjinës. Në rast të shpalljes fitues të një operatori ekonomik të huaj, ky i fundit do të ekuivalentojë licencën sipas legjislacionit përkatës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, nenin 40, pika 5/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar si dhe në Vendimin e Keshillit të Ministrave nr.42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndertimi”, i ndryshuar me VKM nr 92 .DT 19.02.2014 ku janë të përcaktuara kategoritë përkatëse dhe niveli i klasifikimit për licensat e subjekteve që ushtrojnë veprimtari në fushën e ndërtimit.

Llojet e licensave dhe klasifikimi i tyre, sipas kategorive dhe niveleve (gërmave) përkatëse janë bërë në përputhje me natyrën e punimeve respektive dhe vlerën e përllogaritur sipas preventivit të hartuar për këtë objekt.

Sipas VKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, kategoria **NP - 1A** “Punime gërmimi në tokë”: Konsiderohen gërmimet, sistemimet dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjeti, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gërmohet ose sistemohet vegjetale, argjilore, ranore, zhavorrishte ose shkëmbore.

Kjo kategori licence i referohet punimeve të parashikuara në preventiv si hapje gropash, punime gërmim dheu, prerje betoni, prerje asfalti, të cilat parashikojnë edhe gërmim dheu.

Sipas VKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, kategoria **NP - 12 A** “Punime të inxhinierisë mjedisore”: Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime të veprave dhe punimeve të veçanta ose të shpërndara në territor, dhe vlerësimit të kompaktësimit të zhvillimit të qëndrueshëm të ekosistemit, përfshirë të gjitha veprat dhe punimet e nevojshme për aktivitet botanik dhe zoologjik. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar procesin e riaftësimit natyror, botanik, faunistik, konservimin dhe riaftësimin e terrenit të përdorur për karriera e gurore, dhe të baseneve hidrografike, eliminimin e prishjes së ekuilibrave hidrogeologjik nëpërmjet kthimit në toka buke të veprave për stabilizimin e shpateve dhe ripyllëzimeve të punimeve të sistemimit bujqësor dhe të veprave për rivegjetizimin e skarpateve rrugore, hekurudhor të karrierave dhe mbetjeve inerte.

Kjo kategori licence i referohet punimeve të parashikuara në preventiv për mbjelljen e (pemëve) drurëve dekorativ referuar vlerësimit të kompaktësimit të zhvillimit të qëndrueshëm të ekosistemit, përfshirë të gjitha veprat dhe punimet e nevojshme për aktivitet botanik

Sipas VKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, kategoria **N.S – 18 A** “Punime topogjeodezike”: *Konsiderohet zbatimi i rilevimeve topografike speciale që kërkojnë mjete dhe organizim të veçantë, punime topogjeodezike në objekte inxhinierike, punime speciale gjeodezike; rrjeta mbështetëse dhe qëndrueshmëri terrenesh.*

Kjo kategori licence i referohet punimeve të parashikuara në preventiv për rilevimin dhe matjen e hapësirave të gjelberta të pasqyruara në projekt dhe preventiv.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
N.P - 1 A	Punime gjurmimi në tokë.	Gjurmim dhe me ekskavator me zinxhir	A	Brenda vlerës së kufirit të parashikuar në VKM Nr. 42 date 16.01.2008,i ndryshuar.
N.P – 7 A	(Ujësjetlla, gazsjetlla, vajsjetlla, vepra kullimi e vaditje)	Punime për hapjen e gropave të reja, të cilat lidhen me ndërhyrjen në rrugët egzistuese sipas preventivit përkatës. Punime bazuar në azhurnimet e UKT të rrjetit përkatës të rrjetit hidraulik të instaluar në këto rrugë	A	Brenda vlerës së kufirit të parashikuar në VKM Nr. 42 date 16.01.2008,i ndryshuar.
N.P –11 A	Ndërtim nënstacione, kabina të transformatorve, linja e TM dhe shprëndarja e energjisë	Punime për hapjen e gropave të reja, të cilat lidhen me ndërhyrjen në rrugët egzistuese sipas preventivit përkatës. Punime bazuar në azhurnimet e OSHEE e rrjetit përkatës të	A	Brenda vlerës së kufirit të parashikuar në VKM Nr. 42 date 16.01.2008,i ndryshuar.

		rrjetit elektrik (kabulla telefonik, rrjet interneti, fibra optike) të instaluara në këto rrugë		
N.P-12 E	Punime të inxhinierisë mjedisore	Sistemim i terrenit dhe riparim sipërfaqe e gjelbertme f.v drurë dekorativ	A	Brenda vlerës së kufirit të parashikuar në VKM Nr. 42 date 16.01.2008, i ndryshuar.
N.S – 18 A	Punime topogjeodezike	Matja e hapësirave të gjelberta të pasqyruara në preventiv dhe në vendin ku do të kryhen mbjelljet.	A	Brenda vlerës së kufirit të parashikuar në VKM Nr. 42 date 16.01.2008, i ndryshuar.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklarate (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin teknik i cili duhet të ketë një eksperiencë pune jo më pak se 5 vjet në fushën e ofrimit të shërbimit të gjelbërimit, e vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, librezë pune, diplomë përkatëse si dhe të figurojnë në listat e shoqërisë për periudhën **Gusht 2022-Tetor 2022**. Shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtme:

- Librezë pune (përkatëse)
- Diplomë
- Kontrate pune midis tij dhe operatorit ekonomik (e vlefshme).

*Dokumentacioni i kërkuar më sipër paraqitet nga OE me anë të formularit të vetëdeklarimit, sipas shtojcës së përcaktuar në DST dhe sipas Nenit 26 pika 1 të VKM nr.285 datë 19.05.2021, gjithashtu bazuar në pikën 6 të Nenit 26 të VKM nr.285 datë 19.05.2021, theksojmë se dokumentat e kërkuara nga AK për përmbushjen e pikës në fjalë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të

dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Argumentimi: Në bazë të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 77, pika 4, si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, nenit 40, pika 5 b/c), me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht: Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës dhe relacionin teknik.

Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij një **Drejtues Teknik** të cilët kanë një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e kontratës pasi ata janë përgjegjës për zbatimin e kontratës sipas termave të referencës dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit të saj.

Kërkesa për drejtues teknik me një eksperiencë minimale pune 5 vjeçare, bazohet tek lloji dhe specifikat e mallit dhe shërbimit që do të kryhet (furnizim dhe një pjesë punime për vendosjen e drurë dekorativë). Kualifikimet dhe eksperiencën në punë janë kritere të domosdoshme të cilat garantojnë AK se kontraktori ka kualifikimet, eksperiencën dhe njohuritë e duhura në fushën e gjelbërimit, të cilat nuk e vënë në rrezik realizimin e kontratës. Specifikisht kriteri i eksperiencës në punë për përgjegjësin teknik i jep garanci AK se mundësia e riskut në realizimin me sukses të kontratës do të minimizohet. Risqet e mundshme në këtë fushë (mbjellja e drurëve) janë hapja e gropave në diametrin e duhur i cili nuk rrezikon mbjelljet, përdorimi i plehut, humusit, dheut të duhur që ndihmojnë në mbjelljen e kësaj lloji bimësie, pra procese pune të cilat garantojnë një mbirje të sukseshme të mbjelljeve.

2.3.4. Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në terren, të përfshirë në licensën e shoqërisë, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, librezë pune, diplomë përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 (tre) muajt e fundit (**Gusht 2022-Tetor 2022**) të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, konkretisht:

- 1 (një) inxhinier Mjedisi;
- 1 (një) inxhinier Topograf
- 1 (një) inxhinier Hidro
- 1 (një) inxhinier Elektrik

Argumentimi: Në bazë të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 77, pika 4, si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, nenit 40, pika 5 b/c), me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Nevoja për inxhinierët e sipër cituar është e diktuar nga përvoja e mëparshme e AK në këtë lloj kontratash. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të kontratës. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierëve të mjedisit, mekanik, hidro, elektrik dhe topograf është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve të mbjelljeve në terren. Operatorët ekonomikë, duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

Punimet referuar preventivit përfshijnë prerje asfalti, prerje betoni, heqje pllakash rrugore, hapje gropash në rrugë, mansione pune të cilat përfshijnë punën e inxhinierëve të sipër përmendur. Punime për hapjen e gropave të reja, të cilat lidhen me ndërhyrjen në rrugët egzistuese sipas preventivit përkatës. Punime bazuar në azhornimet e rrjetit përkatës të rrjetit elektrik (kabulla telefonik, rrjet interneti, fibra optike) të instaluar në këto rrugë. Punime për hapjen e gropave të reja, të cilat lidhen me ndërhyrjen në rrugët egzistuese sipas preventivit përkatës. Punime bazuar në azhornimet e rrjetit për katë të rrjetit hidraulik të instaluar në këto rrugë.

2.3.5. Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të vërtetojë se disponon kualifikimet e duhura të stafit inxhinierik përkatës si më poshtë me eksperience pune të pakten **5 vjeçare** për kryerjen e të gjitha shërbimeve siç kërkohet në DST. Për këtë operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacion se ka si të punësuar dhe të regjistruar në kompaninë e tij për të paktën 3 muajt e fundit (**Gusht 2022-Tetor 2022**) stafi inxhinierik si më poshtë:

- 1 (një) inxhinier Mjedisit , i paisur me çertifikate nga Ministria e Mjedisit
- 2 (dy) inxhinier Agronom, ku të pakten njëri të jetë i paisur me çertifikate nga Ministria e Mjedisit.
- 1(një) inxhinier pyjesh – profili mbareshttrim-shfrytezim

Per të vërtetuar plotësimin e këtij kriteri Operatori ekonomik duhet të paraqesë Diplomat/kontratat e punës/te vlefshme, dhe cv përkatëse, librezat e punës si dhe certifikatat e kërkuara me siper.

Argumentimi: Në bazë të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 77, pika 4, si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, nenit 40, pika 5 b/c), me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Nisur nga lloji i mallit dhe një pjesë punimesh (furnizim drurë dekorativ dhe një pjesë e kontratës punime furnizim-vendosje) i cili kërkohet, specialisti i fushës i AK ka gjykuar të domosdoshëm stafin i cili do të duhet kontraktorit për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri

për stafin inxhinierik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, relacionin teknik dhe zërat e shërbimit. Nevoja për inxhinierët në terren (vendodhje të ndryshme në Bashkinë Tiranë, ku do të mbillen pemët) është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për shërbimin në fjalë. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të shërbimit. Numri i stafit kryesor të inxhinierëve është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e saj. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Inxhinierët janë përgjegjës për mbarëvajtjen e shërbimit në përputhje me kushtet dhe specifikimet teknike.

Kërkesa për 2 (dy) inxhinier agronom, për1 (një) inxhinier mjedisi dhe një inxhinier pyjesh lidhet me llojin e shërbimit dhe gjithashtu me grafikun e lëvrimin dhe ekzekutimit, ku lloji i mallit (drurë dekorativ), ka specifika të mbjelljes sezonale. Specifikisht, nisur nga fakti se kemi të bëjmë me një kontratë malli që do të kërkohej duke u referuar nevojave të AK, kjo sigurisht duke u bazuar tek specifikat që lidhen me sezonin e mbjelljeve të drurëve (drurët mbillen vetëm gjatë një periudhe kohore të caktuar gjatë vitit, i cili i referohet një cikli me afat të caktuar kohor mujor në varësi të llojit të bimësisë). Ky faktor kërkon praninë e disa inxhinierëve të fushës (inxhinierëve agronom dhe mjedisit në këtë rast) të cilët do të ndjekin nga afër procesin e mbjelljeve. Kriteri në fjalë i jep garanci dhe besueshmëri AK për realizimin me sukses të kontratës.

2.3.6. Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar punonjës si me poshte:

- a) **2 (dy) Teknik mekanik** shoqeruar me kontratë pune, diplome, dhe karte personale të sigurimit teknik të leshuar nga IQT ose organe kompetente në bazë të ligjit 8734 dt 01.02.2001 (i ndryshuar).
- b) **2 (dy) Hidraulik** shoqeruar me kontratë pune, diplome, cv, dhe karte personale të sigurimit teknik të leshuar nga IQT.
- c) **2 (dy) Elektriçist** shoqeruar me kontratë pune, diplome, cv, dhe karte personale të sigurimit teknik të leshuar nga IQT.
- d) **5 (pese) Automakinistë** të cilët duhet të jenë të pajisur me dëshminë e aftësisë profesionale ose leje manovrimi të vlefshme të leshuar nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, (tani Ministria Infrastrukturës dhe Energjisë) dhe karte personale të sigurimit teknik të leshuar nga IQT ose organe kompetente në bazë të ligjit 8734 dt 01.02.2001 (i ndryshuar)..
- e) **5 (pese) Eskavatorista** të cilët duhet të jenë të pajisur me dëshminë e aftësisë profesionale ose leje manovrimi të vlefshme të leshuar nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, (tani Ministria Infrastrukturës dhe Energjisë) dhe karte personale të sigurimit teknik të leshuar nga IQT ose organe kompetente në bazë të ligjit 8734 dt 01.02.2001 (i ndryshuar).

f) **2 (dy) punonës teknik pllaka-shtrues** shoqeruar me kontrate pune, dhe kartele personale te sigurimit teknik te leshuar nga IQT.

g) **2 (dy) punonjës me certifikatë "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë"** në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome, certifikate leshuar nga autoritetet te akredituara pergjegjese shtetore, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi per 3 (tre) muajt e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave.

*Dokumentacioni i kërkuar më sipër paraqitet nga OE me anë të formularit të vetëdeklarimit, sipas shtojcës së përcaktuar në DST dhe sipas Nenit 26 pika 1 të VKM nr.285 datë 19.05.2021, nenit 77 pika 4 te LPP si dhe bazuar në pikën 6 të Nenit 26 të VKM nr.285 datë 19.05.2021, theksojmë se dokumentat e kërkuara nga AK për përmbushjen e pikës në fjalë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në original ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/b/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Nisur nga lloji i mallit dhe një pjese të punimeve (furnizim vendosje) i cili kërkohet, specialisti i fushës i AK ka gjykuar të domosdoshëm stafin i cili do ti duhet kontraktorit për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, relacionin teknik dhe zërat e preventivit. Nevoja për stafin ne terren (vendodhje të ndryshme në Bashkinë Tiranë, ku do të mbillen pemët) është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për shërbimin në fjalë. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të kontrates.

- Kërkesa për 2 (dy) teknik mekanik diktohet nga lloji i procedurës dhe se një pjesë e punëve që do të kryhen (furnzim-vendosje drurësh). Duke patur parasysh se shërbimi i mbjelljes së drurëve dekorativ kërkon mjete të specializuara dhe duhet të kryhet brënda një kohe të caktuar, kjo pasi bimësia e kërkuar ka specifika të caktuara të cilat lidhen me periudhën kohore të mbjelljes. AK e shikon të domosdoshëm këtë kriter pasi në gjykimin e specialistit të fushës është një faktor i cili jep garanci dhe besueshmëri AK për realizimin me sukses të kontratës nga ana e OE.
- Kërkesa për 5 (pesë) automakinistë i referohet gjithashtu faktit se procedura përveç se parashikon blerjen e mallit, parashikon për një pjesë edhe shërbimin e transportit dhe mbjelljes së drurëve dekorative. Kërkesa në fjalë është e diktuar nga përvoja,

legjislacioni dhe lloji i shërbimit. Gjithashtu specifikojmë se në këtë procedurë janë kërkuar mjete si kamion me vinç dhe kamionçina vetë-shkarkuese për realizimin e kontratës. Kërkesa bazohet në: Urdhër nr. 109, datë 5.08.2013 'Për Miratimin e Rregullores "Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e dëshmisë së aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të makinerive të ndërtimi"

- Kërkesa për 5 (pesë) eskavatoristë lidhet ngushtë me llojin e procedurës punime furnizim-vendosje. Lloji i shërbimit parashikon punime të tilla si hapje gropash të reja, prerje asfalti, thyerje betoni, heqje pllakash, gjurmime dhe mbushje me dhe, evadimin dhe transportin e dheut dhe punime të ngjashme me to.

Kërkesa për 2 (dy) punonjës me çertifikatë "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" i referohet faktit se preventivi parashikon punime dhe vendosje drurësh dekorativ sipas specifikimeve teknike. Në përputhje me klauzolat e ligjit 10327 datë 18.02.2010 Për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë.

Personeli përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë është përgjegjës për shpërndarjen e punës dhe realizimin e punimeve në formën dhe mënyrën e kërkuar sipas akteve ligjore në fuqi dhe në përputhje me manualet teknike dhe kushtet teknike të zbatimit, sigurimit teknik dhe mbrojtjes në punë të punonjësve të cilët do të jenë përgjegjës në furnizimin dhe punimet për të përmbushur kushtet e kontratës.

Kërkesa për 2 (dy) punonjës hidraulik dhe 2 (dy) punonjës elektrikist lidhet me punime për hapjen e gropave të reja, të cilat lidhen me ndërhyrjen në rrugët egzistuese sipas preventivit përkatës. Punime bazuar në azhurnimet e OSHE dhe UKT për rrjetin përkatës të rrjetit hidraulik dhe elektrik të instaluar në këto rrugë.

Kërkesa për 2 (dy) punonjës teknik pllaka-shtrues i referohet preventivit të punimeve i cili parashikon heqje të pllakave egzistuese në rrugë dhe instalimin e pllakave të tjera.

2.3. 7. Një punësim mesatar i të paktën 150 personave, për periudhën 3 muajt e fundit (Gusht 2022-Tetor 2022) të vërtetuar me:

- i. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj; për periudhën **Gusht 2022-Tetor 2022**.
- ii. List-pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohej nga legjislacioni në fuqi për periudhën **Gusht 2022-Tetor 2022**

Argumentimi: Në bazë të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", neni 77, pika 4, si dhe VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", neni 40, pika 5 b/c, me anë të këtij kriteri kërkohej që, operatorët ekonomikë të dëshmojnë që

kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Numri i punonjësve është përcaktuar bazuar në afatin (orët e punës që duhen për të përmbushur zbatimin e kontratës, referuar kodit të punës në Republikën e Shqipërisë). Numri i punonjësve, tregon besueshmëri për autoritetin kontraktor. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën, përmasat dhe kohën në dispozicion për zbatimin e kontratës.

Në përcaktimin e numrit të punonjësve specialisti i fushës ka bërë një analizë bazuar tek faktorët, si natyra e mallit objekt kontrate që kërkohet të furnizohet (kemi marrë në konsideratë faktin se malli objekt kontrate ka nevojë ditore për mirëmbajtje dhe shërbime gjatë kohës së qëndrimit në ambientin e vënë në dispozicion nga OE, që nga momenti i lidhjes së kontratës deri në tërheqjen e mallit dhe shprëndarjen e tij në terren). Për procesin e ngarkimit, shkarkimit dhe pozicionimit të mallit objekt kontrate përlllogariten gjithashtu numri i punonjësve. Gjithashtu për punimet e kërkuara sipas përshkrimit në preventiv për vendosje e pemëve. Numri i punonjësve, kualifikimi i tyre, grafiku i lëvrimit dhe natyra e mallit objekt prokurimi, me kohështirje Gusht 2022-Tetor 2022, tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë me sukses kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore e shoqëruara me listpagesat me këtë kohështirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përpiket të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendosja e kriterit për një punësim të paktën 150 punonjës duke përfshirë dhe stafin tekniko menaxherial si dhe stafin administrativ, është në përputhje me volumin e punës, natyrën ku do të kryhen punimet.

Duke qënë se procesi i punës është i ndarë në dy drejtime (furnizim-vendosje) ku në dejtmin e vendosjes OE do të ndodhet në terren në zona të ndryshme nevojitet stafi i nevojshëm sipas profileve të sipërcituara për realizimin e kontratës. Gjithashtu edhe tek furnizimi, edhe tek vendosja, duke qënë se sasia e pemëve është e madhe dhe afati i lëvrimit është i shkurtër, si dhe bazuar tek mjetet të cilat do të funksionojnë me dy apo tre turne, në zbatim të kodit të punës. Për shkak gjithashtu edhe të terrenit dhe rrugëve brënda qyetetit, trafikut të rënduar, kufizimeve në orar në qarkullim, grafikut të punës është i nevojshëm angazhimi i numrit të 150 punonjësve të këkuar sipas profileve përkatës.

Kriteri për kualifikim është vendosur që t'i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë,

kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3.8 Operatori ekonomik duhet të paraqesë çertifikatat si më poshtë:

- a) Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me **çertifikatat ISO 9001 – 2015** për ushtrim të aktivitetit objekt i prokurimit, (të vlefshme dhe e akredituar nga DPA ose Organizma Ndërkombëtar Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë)
- b) Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me **çertifikatat ISO 14001 – 2015** për ushtrim të aktivitetit objekt i prokurimit, (të vlefshme dhe e akredituar nga DPA ose Organizma Ndërkombëtar Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë) ;
- c) Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me **çertifikatat ISO 45001 – 2018** ose ekuivalente për ushtrim të aktivitetit objekt i prokurimit, (të vlefshme dhe e akredituar nga DPA ose Organizma Ndërkombëtar Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë)

Çdo OE pjesëmarrës (çdo anëtar i grupit) në rastet e ‘Bashkimit të Operatorëve Ekonomik (BOE)’ duhet të paraqesë çertifikatat ISO, sipas zërave të shërbimeve që do marrë përsipër të realizojë sipas akt-marrëveshjes.

Argumentimi: *Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, Neni 44 “Kërkesa e cilësisë” pika 1, 3, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”, si dhe nenin 79 të LPP. Certifikatat kërkuara më sipër janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, si dhe çdo operator ekonomik duhet të ketë akses në to, duke mbajtur në konsideratë parimin e mosdiskriminimit. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se plotësojnë standartet e kërkuara të cilësisë dhe standartet për shëndetin dhe sigurinë në punë.*

ISO 9001:2015

ISO 9001 është standardi më popullor i publikuar në nivel ndërkombëtar. Ai përcakton kërkesat për një sistem menaxhimi të cilësisë të cilat mund të implementohen dhe certifikohen nga çdo shoqëri, pavarësisht dimensionit të saj apo fushës së aktivitetit.

Kërkesat e ISO 9001:2015 i referohen aspekteve të ndryshme siç janë: implikimi në menaxhim, identifikimi i riskut dhe mundësive, siguri i konkurrencës për personelin e shoqërisë,

mirëmbajtja e pajisjeve dhe infrastrukturës, matja e kënaqësive të klientëve, përgjigje ndaj ankesave të marra dhe vlerësimi i furnitorëve.

Certifikimi ISO 9001 përfaqëson një konfirmim të faktit që shoqëria respekton një seri kërkesash të pranueshme në nivel ndërkombëtar. Mbajtja e certifikimit sjell disa përparësi për shoqërinë siç janë: akses tek procedurat e tenderave publike, marrëdhënie biznesi me partnerët e njohur apo një imazh më të mirë në sytë e klientëve.

ISO 14001-2015

ISO 14001 është një standard që i referohet sistemit të menaxhimit të mjedisit.

ISO 14001:2015 përqëndrohet tek identifikimi i atyre aktiviteteve që mund të gjenerojnë aspekte domethënëse në mjedis dhe tek aplikimi i masave kontrolluese. Qëllimi është ulja ose eliminimi i efekteve negative mbi mjedisin të lidhura me aktivitetet e shoqërisë.

Aplikimi i ISO 14001 ndihmon shoqërinë të përmirësojë performancën e saj mjedisore nëpërmjet uljes së sasisë të mbetjeve të gjeneruara dhe përdorimin me efikasitet të burimeve natyrore.

ISO 45001:2018

Çdo kompani ka detyrimin të mbrojë shëndetin dhe sigurinë në punë për të gjithë punonjësit.

ISO 45001 është standardi ndërkombëtar i cili përcakton kërkesat për një sistem menaxhimi të shëndetit dhe sigurisë në punë. ISO 45001 zëvendësoi standardin OHSAS 18001.

Kërkesat e standardit ISO 45001 përfshijnë: vlerësimin e rreziqeve të aksidenteve në punë, vendosjen e masave në fushën e shëndetit dhe sigurisë, inkurajimin e pjesëmarrjes së punonjësve në përpjekjet për të përmirësuar kushtet e punës, zbatimin e masave për të zvogëluar rreziqet e aksidenteve dhe sëmundjeve si dhe hetimin e incidenteve.

Certifikimi ISO 45001 mund të merret nga çdo kompani, pavarësisht aktivitetit të saj si dhe risqeve të shëndetit dhe sigurisë.

Ky certifikim konfirmon angazhimin e shoqërisë për të marrë masat e nevojshme për të mbrojtur punonjësit e saj dhe të çdo personi tjetër në ambientet e saj.

2.3.9. Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur nga Qendra Kombëtare e Licensimit me;

- Licensë e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit për grumbullimin dhe transportim të mbetjeve jo të rrezikshme (kodi III.2.B)
- Licensë e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit për prodhime tregtim i farave dhe fidaneve (kodi II.4).
- Licensë e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit për Sherbime ekspertize/ose profesionale lidhur me pyje dhe /ose kullota (Kodi III.7.A).

- Licensë e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit për Shërbime ekspertize dhe /ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis (Kodi III.2.A).
- **Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 40, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Për vet natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është e rëndësishme që operatorët të përmbushin kontratën me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësisë, menaxhimit të mjedisit për një zhvillim të qëndrueshëm është standart që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përsa kohë do të pranohen dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë. (në përputhje me klauzolat e ligjit 10431 datë 09.06.2011 për mbrojtjen e mjedisit i ndryshuar”, me qëllim marrjen e masave parandaluese për mbrojtjen e mjedisit).

2.3.10.Operatori ekonomik duhet të paraqesë kapacitetet teknike që nevojiten për ekzekutimin e kontratës. dhe sasitë përkatëse për mjetet e mëposhtme:

Mjetet	Sasia	Gjendja
Kamjon me vinç	5 copë	Pronësi ose me qera
Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 10(dhjetë) ton	5 copë	Pronësi ose me qera
Kamionçinë	8 copë	Pronësi ose me qera
Makineri për shkulje pemesh	1 copë	Pronësi ose me qera
Eskavator me goma	1 copë	Pronësi ose me qera
Fadrome me goma	2 copë	Pronësi ose me qera
Minieskavator	5 copë	Pronësi ose me qera
Dumper kantieri	4 copë	Pronësi ose me qera

Minifadrome	1 copë	Pronësi ose me qera
Autobot uji	3 cope	Pronësi ose me qera
Vinc me kosh	3 cope	Pronësi ose me qera
Traktor bujqesore	1 copë	Pronësi ose me qera
Prerëse Asfalti	1 copë	Pronësi ose me qera
Gjenerator	1 copë	Pronësi ose me qera
Autobetoniere	1 cope	Pronësi ose me qera

Te paraqiten mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë:

- Kokore dhe jelek minimumi 150 copë
- Komplet i ndihmës së shpejtë minimumi 5 copë
- Tabela paralajmeruese 5 copë

Për Mjetet e mesiperme të kërkuara operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin si më poshtë:

- a) Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë); b) leje qarkullimi; c) çertifikate e kontrollit teknik; d) siguracion mjeti, (i vlefshëm); e) çertifikatë për transport mallrash brënda vëndit (e vlefshme).
- b) Për mjetet e deklaruar me qera duhet të paraqitet: a) kontrata përkatëse noteriale e qerasë e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi b) dokumenti që verteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë) c) leje qarkullimi; ç) çertifikaten e kontrollit teknik, d) siguracion mjeti (i vlefshëm); e) çertifikatë për transport mallrash brënda vëndit (e vlefshme).
- c) Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje si dhe në rastin e mjeteve të treguara duhet të jetë e dukshme targa e mjetit.
- d) Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me anë të së cilës pranon verifikimin e mjeteve dhe pajisjeve të deklaruar në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës nga Autoriteti Kontraktor.
- e) Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës deklaron se mjetet dhe pajisjet e deklaruar nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruar ne procedurat te shpallura fitues nga Autoriteti Kontraktor.

- f) Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë për vendndodhjen e mjeteve ne pronesi ose me qera me qellim verifikimi nga Autoriteti Kontraktor.

*Dokumentacioni i kërkuar më sipër paraqitet nga OE me anë të formularit të vetëdeklarimit, sipas shtojcës së përcaktuar në DST dhe sipas Nenit 26 pika 1 të VKM nr.285 datë 19.05.2021, si dhe në pikën 6 të Nenit 26 të VKM nr.285 datë 19.05.2021, theksojmë se dokumentat e kërkuara nga AK për përmbushjen e pikës në fjalë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.

Argumentimi: *Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ç të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë **mjetet e pajisjet teknike**, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.*

Numri dhe lloji i mjeteve ne pronesi / qira / kontrate furnizimi është minimal në përpjesëtim dhe i lidhur ngushtësisht me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke marrë në konsideratë faktin se malli objekt kontrate do të transportohet nga furnizuesi në ambinetin ku do të magazinohet apo do të mbillet/vendoset sipas kërkesave të autoritetit kontraktor, shoqëruar me punimet përkatëse. Mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës.

Duke qënë se proçesi i punës është i ndarë në dy drejtime (furnizim-vendosje) ku në dejtimin e vendosjes OE do të ndodhet në terren në zona të ndryshme nevojitet stafi i nevojshëm sipas profileve të sipërcituara për realizimin e kontratës. Gjithashtu edhe tek furnizimi, edhe tek vendosja, duke qënë se sasia e pemëve është e madhe dhe afati i lëvrimit është i shkurtër, si dhe bazuar tek mjetet të cilat do të funksionojnë me dy apo tre turne, në zbatim të kodit të punës. Për shkak gjithashtu edhe të terrenit dhe rrugëve brënda qytetit, trafikut të rënduar, kufizimeve në orar në qarkullim, grafikut të punës është i nevojshëm angazhimi i numrit të 150 punonjësve të kërkuar sipas profileve përkatës.

2.3.11. Operatori ekonomik duhet te disponoje (në pronësi ose qira) nje ambient/truall me sipërfaqe minimumi 15,000 (pesëmbëdhjete mije) m2 per magazinimin e pemeve në territorin e Bashkisë Tiranë, pronë e cila do t’i lihet në përdorim dhe bashkëruajtje Autoritetit Kontraktor për 1 vit nga momenti i lidhjes së kontratës. Kjo pronë do t’i shërbejë AK për magazinimin e gjithë mallit të furnizuar. Trualli duhet të jetë i niveluar, duhet të ketë kontratë me OSHEE dhe UKT. Objekti të jetë 6-8 km nga Unaza e Vogël e Tiranës. *Te paraqiten dokumentat e vlefshem*

qe tregon pronesine e ambientit ose kontraten e qerases. Ambienti duhet të jetë lehtësisht i aksesueshëm nga mjetet e tonazhit të rëndë me anë të të cilave do të kryhet dhe zhvendosja e pemëve nga ambienti i magazinimit në zonën e mbjelljeve në qytet. Ambienti do të shërbejë për vendosjen e mallit i shoqëruar me vazo referuar kërkesave të specifikimeve teknike dhe preventivave. Kjo pikë përmbushet nëpërmjet plotësimit të formularit të vetë-deklarimit sipas shtojcës përkatëse.

Argumentimi: Në bazë të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 77, pika 1 (c) dhe 4, si dhe VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, neni 40, pika 8. Kjo pikë vlersohet nga AK si e nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

Duke qënë se kemi të bëjmë me një kohë të limituar referuar VKB 100 datë 19.10.2022 “Për disa ndryshime në Vendimit Nr.166 datë 24.12.2021 për miratimin e programit buxhetor afat-mesëm 2022-2024 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Tiranë për vitin 2022 të ndryshuar. Ky është një fond i akorduar për këtë vit buxhetor, për shkak të nevojave të gjelbërimit, sezonit të mbjelljeve është kërkuar që furnizimi të bëhet sipas afatit të sipër cituara. Në këto kushte AK e ka pamundur të magazinohet këtë sasi pemesh, dhe si rrjedhojë lind nevoja e këtij kushhti. Arsyeja sepse trualli për magazinim duhet të jete në Bashkinë Tiranë është sepse terheqja e pemëve nga magazina do të kryhet gjatë vitit dhe sipas grafikut të punimeve do të bëhet nga mjetet e AK të cilat e kanë të pa lejueshme të punojnë jashtë zonës së Bashkisë Tiranë.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Specifikimet teknike, për procedurën objekt prokurimi janë hartuar nga grupi i punës referuar praktikës e cila është pjesë e dosjes së prokurimit, miratuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor/ Personi i Autorizuar, bazuar në parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, , nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të

prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo dhe çdo standardi të kërkuar.

Pas finalizimit të këtij procesi për përgatitjen e specifikimeve teknike, grupi i punës, bazuar në nenet 34 dhe 36 të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenet 12, 13, nenin 45 pika 2.1 76 të VKM Nr.285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, filloj punën për përllogritjen e vlerës limit të kontratës objekt prokurimi, **bazuar pikes b/ të nenin 76 të VKM-së nr.285**, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, në përllogaritjen e vlerës së fondit limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet të referohet një ose më shumë alternativave të renditura si më poshtë:

b) studimit të tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim.

Afatet e lëvrimit: 15 dite nga data e lidhjes së kontratës.

Te gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skuklifikim.

Të gjitha kriteret në mënyrë më të hollësishme pasqyrohen në DST dhe konkretisht në Shtojcën 7 të **“KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT”**, që ndodhen në dosjen e tenderit objekt prokurimi.

FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve: **“BLERJE PEMË DEKORATIVE PËR PYLLIN ORBITAL DHE ZONA TË NDRYSHME TË TIRANËS”**

Kontrata konsiston në furnizimin me objekt mbjelljen e drurëve dekorativ në territorin e Bashkisë Tiranë. Kontrata ka për qëllim shtimin e bimësisë dekorative në territorin e Bashkisë Tiranë. Referuar politikave të gjelbërta të implementuara nga Bashkia Tiranë, gjithashtu në përmbushje të Planit të Veprimit “Qyteti i Gjelbër” në rekomandimet e lëna nga KLSH nënvizohet se: “Bashkia Tiranë, në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm të shërbimeve ndaj qytetearit, lidhur me hapësirat publike, gjelbërimin e qytetit, duhet të synojë në drejtim të rritjes dhe forcimit të masave për shtimin e hapësirave të gjelbëra të reja, që kjo bashki administron. Politikat e ndjekura në këtë drejtim, sa i takon objektivit 2 të shprehura në Planin e Veprimit “Qyteti i Gjelbër” janë ambicioze por ato duhet të shoqërohen me kapacitete të mjaftueshme financiare dhe logjistike nga ana e Bashkisë”.

Projekti i Pyllit Orbital për mbjelljen e pemëve, për shkak të pamundësive financiare për mbështetje me buxhet, si dhe problematikave që lidhen me mungesën e hapësirave të nevojshme për mbjellje dhe çështjeve të pronësisë rezulton me një nivel të ulët realizimi, megjithëse ka kaluar një pjesë ekonsiderueshme e periudhës së zbatimit të këtij objekti. Objektivat e tjerë të parashikuar në Planin e Veprimit që lidhen me shtimin e hapësirave të gjelbëra me gjithë fokusin e Bashkisë Tiranë rezultojnë të realizuara jo në nivelet e pritshme dhe në përgjigje të ritmeve të rritjes së urbanizimit”.

Mbjellja e “Pyllit Orbital” si projekt strategjik i BT, i cili ndër të tjera përfshin edhe Parkun e Lumit të Tiranës (sipas pikes e. Rregullat dhe Kushtet për Realizimin e Pyllit Orbital të Tiranës), i cili përcaktohet si një instrument për frenimin e konsumit të tokës, duke ruajtur burimet bujqësore natyrore, shpërhapjen urbane e indentifikuar si kufi fizik i zhvillimit dhe zgjerimit të sistemit urban në mjedisin natyror, ka nevojë për shtim të gjelbërimit dhe mbjelljeve të reja të bimësisë dekorative, sipas tipeve, llojeve dhe kushteve teknike bazë të drurëve dhe shkurreve konform legjendës përkatëse.

Mbjelljet parashikohet të kryhen në 27 njësitë administrative të Tiranës, ndër to veçojmë:

Parku i Lumit të Tiranës (Pjesë e Pyllit Orbital).

Rruga "Vangjel Capo"

Rruga "Marije Kraja"

Rruga "Ismail Qemali"

Rruga e Elbasanit

Rruga "Odise Paskali"

Shkolla "Bajram Curri"

Sheshi Strauss

Autostrada, rruga dytësore

Rruga "Dervish Hekali"

Rruga 4 Dëshmorët

Shkolla "Dëshmorët e 4 shkurtit"

Pallatet Çabej

Rruga "Muhamed Deliu"

Rruga "Hamdi Sina"

Pazari i Ri

Rruga "Vaso Pasha"

Rruga e Dibrës

Rruga "Imer Ndregjoni"

Rruga "Xhenfize Keko"

Fresku (Aleksandër Moisiu)

Rruga Mine Peza

Rruga Durrësit

Myslym Shyri

Rruga Kavajes

Rruga Sami Frashëri

Rruga Ibrahim Rugova

Rruga Abdyl Frashëri

Rruga Nikolla Tupe

Rruga Donika Kastrioti

Brigada VII

Rruga Pjetër Bogdani

Rruga 4 Dëshmorët

Rruga e Dibrës

Një pjesë e drurëve dhe shkurreve dekorative, *gjithsej 24623 copë drurë dhe shkurre dekorative do të magazinohen brënda një afati 15 ditor në ambientet e magazinimit të Operatorit Ekonomik i cili do të shpallet fitues*. Këto drurë dhe shkurre do të tërhiqen nga ambientet e magazinës së OE të shpallur fitues nga AK sipas një plani të përcaktuar mbjelljesh në sezonin e mbjelljeve.

Një pjesë e drurëve (përkatësisht 1058 drurë dekorativ) do të furnizohen dhe vendosen brënda një afati 15 ditor referuar preventivave përkatës të furnizim-vendosjes.

Kriteret e kualifikimit janë vendosur në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës me qëllim që të vërtetohet se operatorët ekonomikë që do të marrin pjesë në këtë procedurë prokurimi kanë

kapacitetet ligjore dhe kualifikimet e nevojshme teknike e profesionale si edhe pervojën e duhur për përmbushjen me sukses të kontratës, objekt i këtij prokurimi, e cila ka një specifikë të vecantë .

NJËSIA E PROKURIMIT: